



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
 Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
 Ministry of Local Government Administration

Për:	Mytahir Haskuka, Kryetar i Komunës së Prizrenit Artan Abrashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Prizrenit	
Cc:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Adrijana Hodžić, Ministre e MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Date: 11/12/2019 Nr.020-1173
Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave	
Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Jeton Qela, Zyrtarë i Lartë për Monitorim të Komunave	
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë	
Lloji i aktit:	Vendim i kuvendit të komunës	

I nderuar Kryetar,
 I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr.02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim Nr.001/011-160724 mbi hyrjen në koncesion të pronës komunale
I miratuar më datë: 11/11/2019
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 18/11/2019

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson së akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjisllacionit në fuqi.

Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

Nr.	Formulimi në aktin e komunës	Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim
1.	Vendim Nr.001/011-160724 mbi hyrjen në koncesion të pronës komunale	<p>Vendimi Nr.001/011-160724 mbi hyrjen në koncesion të pronës komunale është në kundërshtim me Ligjin Nr.06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, duke i'u referuar dispozitave të këtij ligji i cili nuk rregullon procedurën e koncesionit.</p> <p>Gjithashtu, Vendimi është në kundërshtim me Ligjin Nr.04/L-045 për Partneritet Publiko Privat, pasi nuk janë zbatuar kriteret dhe procedurat e përcaktuara për partneritet publiko privat. Si i tillë, Vendimi është i paqartë, me dispozita të paqarta.</p>

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, kërkon nga Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës së Prizrenit që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za:	Mytaher Haskuka, gradonačelnika Opštine Prizren Artan Abrashi, predsedavajući Skupštine opštine Prizren	
Cc:	Jedinica za upravljanje dokumentima u MALS Jedinica za upravljanje dokumentima u opštini	
Preko:	Adrijana Hodžić, ministarka administracije lokalne samouprave Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-a	
Od:	Venera Çerkini, rukovodilac Pravnog odeljenja i nadgledanje opština, MALS	Dana: 11.12.2019. Br. 020-1173
Odgovorni službenici:	Xhevat Tafa, rukovodilac Odseka za nadgledanje opština	
1. Potvrđeno od:		
2. Izrađeno od:	Jeton Qela, viši službenik za nadgledanje opština	
Predmet:	Zahtev za ponovno razmatranje zakonitosti	
Vrsta akta:	Odluka Skupštine opštine	

Poštovani gradonačelnice,
Poštovani predsdevajući,

U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosova br.10/2019 za administrativno razmatranje opštinskih akata, i na osnovu zakonskih nadležnosti ministarstva, određenim osnovnim zakonima i Vladinom Uredbom br.02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta premijera i ministarstva, Pravnom odeljenju i nadgledanje opština Ministarstva za administraciju lokalne samouprave je dostavljen sledeći opštinski akt za obavezno razmatranje zakonitosti, onako kako se predviđa članom 81 Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi:

Odluka br.001/011-160724 o koncesiji opštinske imovine

Usvojena dana: 11.11.2019. godine.

Dotsavljena MALS-u za razmatranje dana: 18.11.2019. godine.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog opštinskog akta, ceni da je opštinski akt u suprotnosti sa odredbama zakonodavstva na snazi.

U nastavku možete naći neslaganja opštinskog akta koji je dostavljen za razmatranje zakonitosti:

Br.	Formuliranje u opštinskom aktu	Zakonska odredba sa kojom je opštinski akt u suprotnosti.
1.	Odluka br.001/011-160724 o koncesiji opštinske imovine	Odluka br.001/011-160724 o koncesiji opštinske imovine u suprotnosti je sa Zakonom br.06/L-092 o davanju na korišćenje i razmenu nepokretne imovine opštine, pozivajući se na odredbe ovog zakona koji ne reguliše postupak koncesije. Takođe, Odluka je u suprotnosti sa Zakonom br. 04 / L-045 o javno privatnom partnerstvu, jer kriterijumi i procedure za javno-privatno partnerstvo nisu primenjeni. Kao takva, Odluka je nejasna, sa nejasnim odredbama.

Na osnovu gore navedenog, Ministarstvo administracije lokalne samouprave *traži* od Skupštine opštine i gradonačelnika Opštine Prizren da preduzmu konkretne mere kako bi se opštinski akt uskladio sa zakonskim odredbama na snazi, u roku od 30 dana od dana dostavljanja zahteva za ponovno razmatranje akta.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštine za bilo kakvo objašnjenje u vezi sa ovom procenom.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Kosovo Community

Prizreni, 11. nëntor 2019
001/011-160724 / 11.11.2019

HYRËSIA E AZRAN-INCOMING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLICA KOSOVO REPUBLIC OF KOSOVA
GENERALI KOSOVES YLJAK KOSOVO GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministry of Local Government Administration
Ministry of Local Government Administration

Data
18.11.2019

Opština Prizren - Nr. i Lëndës: 020-1171

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren - Prizren Belgrade

Në bazë të nenit 12 paragrafi 1, 2, pika d), të Ligjit Nr. 031/040, për Vetëqeverisje Lokale, Ligjit nr. 041-045 mbi partneritetin publiko-privat, Ligjit nr. 061-092, për shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paltrajtshme të komunës, si dhe nenit 27 paragrafi 1, të Statutit të Komunës së Prizrenit, nr. 01/011-5043, dt.15 tetor 2008, pas shqyrtimit të propozimit të kryetarit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Prizrenit, në mbledhjen e mbajtur më 11 nëntor 2019, miratoi kështu:

**VENDIM
MBI HYRJEN NË KONCESION TË PRONËS KOMUNALE**

Neni 1

Aprovohet: propozimi i Kryetarit të Komunës, i cili ka për qëllim arritjen e marrëveshjes për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale me kompensim - me koncesion dhe atë të pjesës prej 459^{m²} nga pjesa e përgjithshme prej 23034^{m²}, të ngastrës kadastrale nr. 08628-15 ZK-Prizren, e cila ngasë është e përfshirë në hapësirën për të cilën është miratuar Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Planit Rregullues Urban (të hollësishtëm) "Qendra e Re" e qytetit të Prizrenit, Vendimi Nr.01/011-75670, në datë 28 prill 2010, të miratuar nga ana e Kuvendit të Komunës për atë zonë.

Neni 2

Në bazë të këtij vendimi, autorizohet Kryetari i Komunës, të hyjë në marrëveshje për shfrytëzim me koncesion me kompensim për sipërfaqen e pronës komunale të cekur sikurse në nenin 1 të këtij vendimi, pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Prizrenit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim, Hapësirat.

Neni 4

Ky Vendim hyj në fuqi pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 031/040, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KOMUNA E PRIZRENIT
Kuvendi i Komunës
Nr. 001/011-160724
Më: 11 nëntor 2019
Prizren

Kryesuesi i Kuvendit
Artan Abrashi

